

VENDIM
Nr. 967, datë 25.10.2013

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT TË
MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

(Ndryshuar me VKM nr. 335, datë 22.4.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve bashkërendon detyrat e ministrive për menaxhimin e integruar mjedisor të mbetjeve në Republikën e Shqipërisë.

2. Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve kryesohet nga zëvendësministri që mbulon çështjet e mjedisit dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- a) Zëvendësministrin që mbulon çështjet e pushtetit vendor;
- b) Zëvendësministrin që mbulon çështjet e mbrojtjes dhe të emergjencave civile;
- c) Zëvendësministrin që mbulon financat dhe buxhetin;
- ç) Zëvendësministrin që mbulon çështjet e infrastrukturës së mbetjeve;
- d) Zëvendësministrin që mbulon çështjet e arsimit;
- dh) Zëvendësministrin që mbulon çështjet e drejtësisë;
- e) Zëvendësministrin që mbulon fushën e shëndetësisë;
- ë) Zëvendësministrin që mbulon çështjet e integrimit evropian;
- g) Zëvendësministrin që mbulon çështjet e bujqësisë;
- gj) Përfaqësuesin e kabinetit të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

3. Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve mbledhet me thirrjen e kryetarit dhe mbledhjet e këtij Komiteti zhvillohen sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 8480, datë 25.8.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

4. Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve kryen këto detyra:

- a) përgatit programin e organizimit të veprimtarisë së tij;
- b) planifikon masat dhe përparësitë e veprimit të Komitetit;
- c) shpall fillimin dhe përfundimin e emergjencës mjedisore në vend;
- ç) shqyrton, analizon dhe propozon masa të domosdoshme, ligjore dhe administrative, për administrimin e mbetjeve mbështetur në katër shtyllat kryesore të politikës: planifikim, edukim, burime dhe legjislacion;

d) ngre grupe pune për evidentimin e problemeve për vlerësimin e ndikimit në shëndet dhe harton e miraton plane operationale për përmirësimin/zgjidhjen e tyre;

dh) propozon krijimin e task-forcës mjedisore në rastet e emergjencave mjedisore;

e) krijon Grupin Kombëtar Këshillimor për Mbetjet (GKKM), si dhe përcakton detyrat, përbërjen, kompetencat e mënyrën e funksionimit të tij;

ë) kryen dhe çdo funksion tjetër që nuk është kompetencë e institucioneve të tjera, të përcaktuara në legjislacionin mjedisor.

5. Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, me anë të anëtarëve të tij pranë

ministrive, siguron që çdo ministri të ketë një politikë të përbashkët dhe të unifikuar për administrimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit.

6. Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve garanton një konsultim ndërministror, gjatë të cilit trajtohen administrimi i mbetjeve dhe mjedisi në një nivel të lartë politik, duke siguruar që këto çështje të merren parasysh nga të gjitha ministrinë.

7. Në rastet kur ka një kosto të menaxhimit të mbetjeve, që lidhet me përputhshmërinë me standardet mjedisore, Ministria e Mjedisit siguron që ministria e prekur të llogaritë dhe t'i raportojë paraprakisht Komitetit për koston përkatëse.

8. Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve paraqet për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave raportin vjetor për gjendjen dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve, në shkallë vendi.

9. Ky Komitet mbledhet jo më pak se një herë në tre muaj për të shqyrtuar e për të miratuar dokumentet dhe aktet që lidhen me menaxhimin e mbetjeve.

9/1 Mbledhjet e Komitetit organizohen dhe asistohen nga sekretariati teknik, rol të cilin e kryen sektori teknik për mbetjet pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

10. Në mbledhjen e parë të çdo viti, Komiteti miraton programin e punës. Në rastet kur në Komitet paraqiten çështje të reja për diskutim, që lidhen me menaxhimin e integruar të mbetjeve apo me situatat emergjente mjedisore të krijuara, kryetari propozon rishikimin e programit dhe ia paraqet për miratim Komitetit.

11. Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, kur e sheh të arsyeshme, thërret ekspertë të fushës dhe përfaqësues të shoqërisë civile për diskutimin e çështjeve të veçanta që lidhen me mbetjet.

12. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe ministrinë e përmendura në pikën 2 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama